DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020 - 1030/2
-VI-
Data Datum Date 14.09.2018

# Republika e Kosovës

**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**

**Qeveria - Vlada – Government**

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për : | **Xhafer Gashi**, Kryetar i Komunës së Obiliqit<br>**Burim Gërguri**, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Obiliqit | |
| Cc: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | **Ivan Todosijević**, Ministër i MAPL-së<br>**Rozafa Ukimeraj**, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së | |
| Nga: | **Xhevat Tafa**, U.d Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL | Date:<br>05/09/2018 |
| Lënda: | Kërkesë për rishqyrtimin e Aktit të Kuvendit të Komunës së Obiliqit | Nr. 020-1030 |
| Lloji i aktit | Vendim | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendim Nr. 1-128 përfundimtar për dhënien në shfrytëzim të pronës së Paluajtshme të Komunës së Obiliqit në zonën kadastrale Obiliq |
| I miratuar më datë: 31.08.2018 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 05.09.2018 |

Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **<u>është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi</u>**.

**Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:**

| **Nr.** | **Formulimi në aktin e komunës** | **Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.** |
|---|---|---|
| 1. | Vendimi Nr. 1-28 përfundimtar për dhënien në shfrytëzim të pronës së Paluajtshme të Komunës së Obiliqit në zonën kadastrale Obiliq | Ky vendim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 04/L-144, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës përkatësisht Nenin 9.1 të këtij ligji si dhe nenin 18.2 të Rregullores (QRK) Nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës pasi që në procesin e votimit ky vendim është miratuar me 9 vota për. Në rastin konkret vendimi miratohet me së paku 11 vota për, nga gjithsejtë 21 anëtarët e kuvendit të komunës së Obiliqit. |

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ***kërkon*** nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës së Obiliqit, që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-1030/2
-VI- Data Datum Date 14.09.2018

# Republika e Kosovës

## Republika Kosovo - Republic of Kosovo

### Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| **Za :** | **Xhafer Gashi**, gradonačelnik opštine Obilić<br>**Burim Gërguri**, predsedavajući Skupštine opštine Obilić | |
| **Kopija** | Jedinica za administraciju dokumenata u MALS-u<br>Jedinica za administraciju dokumenata u opštini | |
| **Preko:** | **Ivan Todosijević**,, ministar MALS-a<br>**Rozafa Ukimeraj**, generalnog sekretara u MALS-su | |
| **Od:** | **Xhevat Tafa**, V.d. rukovodioca pravnog odeljenja i monitorisanje opština | Datum: 05.09.2018.<br>Br. 020-1030 |
| **Predmet:** | Zahtev za ponovno razmatranje odluke Skupštine opštine | |
| **Vrsta akta:** | Odluka | |

Poštovani gradonačelniče,
Poštovani predsedavajući

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne kancelarije premijera i ministarstva, odeljenje za pravna pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je na obavezno razmatranje zakonitost akta opštine kako je predviđeno članom 81 Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi, kao u nastavku:

| |
|---|
| Konačna odluka br.1-128 za davanje opštinske nepokretne imovine na korišćenje opštine Obilić, u katastarskoj zoni Obilić |
| Usvojena dana: 31.08.2018 godine |
| Predložena na razmatranje u MALS-u dana: 05.09.2018 godine |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja gore navedenog sadržaja akta opštine, procenjuje da je isti u suprotnosti sa odredbama zakona na snazi.

Neusaglašenost akta opštine koji je predložen na razmatranje zakonitosti je kao u nastavku:

| Br. | **Formulisanje akta opštine** | **Zakonske odredbe sa kojima je akat opštine u suprotnosti.** |
|---|---|---|
| 1. | Konačna odluka br.1-128 za davanje opštinske nepokretne imovine na korišćenje opštine Obilić, u katastarskoj zoni Obilić. | Ova odluka je u suprotnosti sa Zakonom br. 04 / L-144 o upotrebi i razmeni nepokretne imovine opštine, odnosno člana 9.1 ovog zakona i člana 18.2 Uredbe (KRK) br. 23/2013, za utvrđivanje procedura za dodjelu i razmjenu nepokretne imovine opštine, jer je u postupku glasanja ova odluka odobrena sa 9 glasova za. U konkretnom slučaju, odluka se usvaja sa najmanje 11 glasova za ukupno 21 člana Skupštine opštine Obilić. |

Iz gore navedenog, Ministarstvo administracije lokalne samouprave od gradonačelnika i Skupštine opštine traži da preduzmu konkretne mere kako bi akat opštine uskladili sa zakonskim odredbama na snazi u vremenskom roku od 30 dana, od dana primanja zahteva na razmatranje akta opštine. Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo koje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.

Nr. -1-128 Data 31.08.2018

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo - Republic of Kosova**
**Qeveria - Vlada - Government**
**Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq**

Në mbështetje të nenit 12.14.2 ,17 pika c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 9 pika 1 dh 2 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012, neni 18.2. të Rregullores nr.23/2013 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 44.1 dhe 47.3 Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.I-34 të datës 25.04.2016, dhe neni 39 i Rregullorës së Punës së Kuvendit nr.I-95,dt.29.06.2018 dhe raporti përfundimtar i komisionit vlerësues me nr : I-115 ,dt.08.08.2018.
Kuvendi Komunës në mbledhjen e mbajture me date 31.08.2018 mori këtë:

# VENDIM

## PËRFUNDIMTAR PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË OBILIQIT NË ZONËN KADASTRALE NË OBILIQ

**I**

Miratohet Vendim për dhënien e pronës së paluajshme të Komunës , në shfrytëzim afatgjatë ofertuesit N.T.P .UNION.

**II**

Sipas pikes I të këtij vendimi :

1. N.T.P .UNION është shfrytëzues i pronës të paluajtshme të Komunës
2. Prona e Komunës gjenden në zonën kadastrale Obiliq , ngastra kadastrale: P-72614055-01790-24, sipërfaqja 3221 $m^2$ , ZK Obiliq. në sipërfaqe total prej **3221 $m^2$** bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme
3. Shrytëzimi i pronës do të jetë për 99 vjet nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi , pas përfundit të këtij afati , prona i kthehet titullarit .
4. Në pronën e paluajtëshme të Komunës do të ndërtohet objekti për nevoja të N.T.P.UNION

III

Dhënia në shrytëzim e pronave të paluajtëshme të cekur në pikën II , bëhet me kompenzim ( sipas RREGULLORES PËR TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE )

IV

Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë , të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shryetëzuesit të pronave të paluajtshme të Komunës

V

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Ekonomi Financa dhe Zhvillim

VI

Obligohet Drejtoria e Planifikimit Uraban , Kadastër dhe Pronë që pas përfundimit të zbatimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës të regjistron në librat kadastral si prona të dhëna në shfrytëzim për periudhë afatgjatë.

VII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyren e protokolit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

**Kuvendi i Komunës së Obiliqit**
Nr. I-125 - , më 31 Gusht 2018

T'i dërgohet
-Kryetarit
-Kryesuesit
-Nënkryetarit
-MAPL
-Palës
-Anëtarëve të Kuvendit
-Arkivit

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal**
**Burim Gërguri**

REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVO

Nr. -I-115 Data 08.08.2018

KOMUNA E OBILIQIT-KOSOVË

OPSTINA OBILIĆ - KOSOVO

MUNICIPALITY OF OBILIQ - KOSOVO

| |
|---|
| ***Data 08.08.2018*** |
| ***Për: Kryetarin e Komunës z.Xhafer Gashi***<br>***Kryesuesin e Kuvendit z. Burim Gërguri*** |
| ***Nga: Komisioni Vlerësues Për Dhënien E Pronës Komunale Në Shfrytëzim*** |
| ***Lënda: Raporti përfundimar i komisionit vlerësues*** |

Duke u bazuar në Vendimin e Kuvendit Komunal nr.-I-24 i dt.:28.02.2018, për formin e Komisionit Vlerësues për Dhënien e Pronës Komunale në Shfrytëzim,Njoftimin për pjesëmarrje në Konkurs Publik nr.-I-85 të dt.: 23.05.2018, Ligjit nr.04/L-144, Nenit 6 për Dhënien Në Shfrytëzim Dhe Këmbimin E Pronës Së Paluajtshme Të Komunës, Rregullores QRK nr.23/2013 Për Përcaktimin E Procedurave Të Dhënies Në Shfrytëzim Dhe Këmbimit Të Pronës Së Paluajtshme Të Komunës[1].

Komisioni në përbërje të plotë dhe në mënyrë unanime pas procesit të vlerësimit të ofertave sipas kritereve të parapara në Njoftimin nr.-I-85 i dt.23.05.2018, nxjerrë këtë rekomandim për Kryetarin e Komunës dhe Kryesuesin e Kuvendit të Komunal:

RAPORT PËRFUNDIMTAR

Komisioni rekomandon këta përfitues të ofertave për periudhën për 99 viteve:

1. Për ngastrat kadastrale: P-72602001-00505-5, sipërfaqja 2698$m^2$, P-72602001-00503-1 sipërfaqja 6653$m^2$, ZK Babimoc, bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme rekomandojmë që përfitues i këtyre parcelave të shpallet "Burimi" SH.P.K.

2. Për ngastrën kadastrale: P-72614055-01790-24, sipërfaqja 3221$m^2$, ZK Obiliq, bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme rekomandojmë që përfitues i kësaj parcele të shpallet, N.T.P.UNION.

3. Për ngastrat kadastrale: P-72614055-01790-28 sipërfaqja 1891m$^2$, P-72614055-01790-30 sipërfaqja 1004m$^2$ dhe P-72614055-01790-11 sipërfaqja 4502m$^2$, ZK Obiliq, bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme rekomandojmë që përfitues i kësaj parcele të shpallet "Agro Kor" SH.P.K.

4. Për ngastrat kadastrale: P-72614055-01279-15 sipërfaqja 577m$^2$, P-72614055-01279-10 sipërfaqja 2451m$^2$, P-72614055-01279-7 sipërfaqja 2504m$^2$, P-72614055-01279-4 sipërfaqja 2973m$^2$ dhe P-72614055-01279-3 sipërfaqja 2881m$^2$ ZK Obiliq. Bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme rekomandojmë që përfitues i këtyre parcelave të shpallet, POLIGONI i SHENJËTARISË "KATANA" SH.P.K.

5. Për ngastrën kadastrale nr.: P-72614051-00562-1, sipërfaqja 10503 m$^2$, ZK Milloshevë, bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme rekomandojmë që përfitues i kësaj parcele të shpallet ofertuesi, Sami Saraqi.

Aplikuesit të cilët janë refuzuar nga ana e komisionit:

1. Ofertuesi "INKSTATION" i cili ka ofertuar për parcelen P-72614055-01790-24 në sipërfaqe 3221m$^2$.

2. Ofertuesi "Kolegji Biznesi" i cili ka ofertuar për parcelen P-72614055-01790-26 në sipërfaqe 675m$^2$.

3. Ofertuesi "Las Palmas" i cili ka ofertuar për parcelen P-72614055-01790-30 në sipërfaqe 1004m$^2$.

Të gjithë pjesëmarrësit në konkursin publik nr.-I-85 të dt. 23.05.2018, të cilët nuk janë rekomanduar/përzgjedhur nga komisioni vlerësues, kanë të drejtë ankese në afat prej 15 dite nga dita publikimit të Raportit Përfundimtar në web faqen e Komunës dhe tabelen e shpalljeve.

Anëtarët e komisionit :

- Përparim Klinaku - Kryetar ____________
- Naim Miftari - Anëtar ____________
- Fatmir Bërbatovci - Anëtar ____________
- Armend Rushiti - Anëtar ____________
- Labinot Mirena - Anëtar ____________
- Dragan Danqetoviq - Anëtar ____________
- Zelushe Kelmendi - Anëtar ____________

Nr. 1-24
Data 28.02.2018

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 44.1 dhe 47.3 të Statutit të Komunës dhe nenit 11 dhe 3.9 të Rregullores së punës të Kuvendit, bazuar në Ligjin nr.04/L-144, për dhënjen në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, neni 6 dhe 7, Rregullorja nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënjes në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, neni 11, 12, Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.02.2018, mori këtë:

# V E N D I M

1.Formohet Komisioni vlerësues për dhënjen e pronës komunale në shfrytëzim me këtë pëbërje:

1. Labinot Mirena, - Kryetar
2. Armend Rushiti, - anëtar
3. Dragan Dancetovic, - anëtar
4. Fatmir Bërbatovci, - anëtar
5. Naim Miftari, anëtar
6. Përparim Klinaku, anëtar

2.Obligohet Komisioni që për punën e vet të përpiloj procesverbal me shkrim dhe për këtë ta njoftoj Kuvendin komunal.

3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyren e protokolit të MAPL-së, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

T'i dërgohet
-Kryetarit
-Kryesuesit
-Drejtorit të ad.së përgj.
-DPUKP
-Anëtarëve të Komisionit
-Këshilltarëve
-MAPL
-Arkivit

Kryesues i Kuvendit komunal
Burim Gërguri

01-116 30.04.2018

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 44.1 dhe 47.3 të Statutit të Komunës dhe nenit 11 dhe 3.9 të Rregullores së punës të Kuvendit, bazuar në Ligjin nr.04/L-144, për dhënjen në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, neni 6 dhe 7, Rregullorja nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënjes në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, neni 11, 12, bazuar në kërkesën për rishqyrtim të ligjshmërisë se aktit të Kuvendit të Komunës me nr.020-331/13, të dt.23.03.2018 (MAPL), Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt.30.03.2018, mori këtë:

# V E N D I M

1. Plotësohet Komisioni për vlerësimin e ofertave për dhënjen e pronës së Paluajtshme të Komunës në shfrytëzim me nr.1-24, të dt.28.02.2018 me këtë anëtare:

   Zeliushe Kelmendi (shoqëria civile)

2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyren e protokolit të MAPL-së, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

I'i dërgohet
-Kryetarit
-Nënkryetarit
-Kryesuesit
-Drejtorit të ad.së përgj.
-DPUKP
-Anëtares
-Këshilltarëve
-MAPL
-Arkivit

Kryesues i Kuvendit Komunal
Burim Gërguri

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 12.2. pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 40.1 dhe 47.3 të Statutit të Komunës dhe nenit 11 dhe 3.9 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt 28.07.2016, mori këtë:

# V E N D I M

I. Komisioni vlerëues për dhënjen e pronës së paluejtshme komunale, përveç kritereve në bazë të nenit 13, të Rregullores nr.23/2013, pika 6, (kriteret tjera të cilat mund të përcaktohen me konkurs) duhet ti refuzoj ofertat që parashohin mundësi të investimit me kapacitete që në qfarëdo mënyre ndikojnë negativisht në gjendjen ambientale sipas ligjeve në fuqi të Kosovës dhe standardeve të Bashkimit Evropian (BE).

II. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyren e protokolit të MAPL-së, si dhe publikimit në web faqen e Komunës.

T'i dërgohet
-Kryetarit,
-Drejtorit të Ad.së përgj.
-Nënkryetarit,
-Kryesuesit,
-DPUKP,
-MAPL-së,
-Anëtarëve të Komisionit,
-Këshilltarëve,
-Arkivit

Kryesuesi i Kuvendit komunal
Adem Preniqi

Nr. 01-58 Data 30-03-2018

**Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova**
**Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq**

Në mbështetje të nenit 12,14 ,17 pika c) dhe nenit 58 pika h), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 6,7 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës se Kosovës e datës 22 nëntor 2012, neneve 11,12 të të Rregullores nr.23/2013 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 72 pika 1.1.8 Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.1-34 të datës 25.04.2016, Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt.30.03.2018 mori këtë:

# VENDIM

## PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË OBILIQIT NË ZONAT KADASTRALE OBILIQ-MILLOSHEVË-BABIMOC

### Neni 1

Me këtë Vendim jepen në shfrytëzim afatgjatë prej 15 deri 99 vite personave fizik dhe juridik paluajtshmëritë që gjenden në zonat kadastrale në Obiliq-Milloshevë-Babimoc për ngastrat kadastrale:

-Ngastra kadastrale P-72614055-01790-11 në vendin e quajtur "DRAGODAN" Lloji i shfrytëzimit të parcelës-tokë ndërtimore , me sipërfaqe prej 4502 m² e evidentuar në Certifikatën e pronës nr.05-238-2018 e dt.29.03.2018 ZK.Obiliq e evidentuar si Pronë "Pasuri Shoqërore Kuvendi Komunal".

-Ngastra kadastrale P-72614055-01790-24 në vendin e quajtur "DRAGODAN" Lloji i shfrytëzimit të parcelës-bujqësore.Arë e kl.2 , me sipërfaqe prej 3221m² e evidentuar në Certifikatën e pronës nr.05-238-2018 e dt.29.03.2018 ZK.Obiliq e evidentuar si Pronë "Pasuri Shoqërore Kuvendi Komunal"

-Ngastra kadastrale P-72614055-01790-26 në vendin e quajtur "DRAGODAN" Lloji i shfrytëzimit të parcelës-Tokë ndërtimore , me sipërfaqe prej 675 m² e evidentuar në Certifikatën e pronës nr.05-238-2018 e dt.29.03.2018 ZK.Obiliq e evidentuar si Pronë "Pasuri Shoqërore Kuvendi Komunal"

-Ngastra kadastrale P-72614055-01790-28 në vendin e quajtur "DRAGODAN" Lloji i shfrytëzimit të parcelës-bujqësore , me sipërfaqe prej 1891 m² e evidentuar në Certifikatën e pronës nr.05-238-2018 e dt.29.03.2018 ZK.Obiliq e evidentuar si Pronë "Pasuri Shoqërore Kuvendi Komunal"

-Ngastra kadastrale P-72614055-01790-30 në vendin e quajtur "DRAGODAN" Lloji i shfrytëzimit të parcelës-bujqesore.Arë-2 me sipërfaqe prej 1084 m² e evidentuar në Certifikatën e pronës nr.05-[illegible]230-2018 i dt.29 .03.2018 ZK.Obiliq e evidentuar si Pronë "Pasuri Shoqërore Kuvendi Komunal"

-Ngastra kadastrale P-72614055-01279-3 në vendin e quajtur "Novi Obiliq" Lloji i shfrytëzimit të parcelës-bujqësore.Arë e kl.1 , me sipërfaqe prej 2881m² e evidentuar në Certifikatën e pronës nr.05-238-2018 e dt.29.03.2018 ZK.Obiliq e evidentuar si Pronë "Pasuri Shoqërore Kuvendi Komunal".

-Ngastra kadastrale P-72614055-01279-4 në vendin e quajtur "Novi Obiliq" Lloji i shfrytëzimit të parcelës-bujqësore.Arë e kl.1 , me sipërfaqe prej 2973$m^2$ e evidentuar në Certifikatën e pronës nr.05-238-2018 e dt.29.03.2018 ZK.Obiliq e evidentuar si Pronë "Pasuri Shoqërore Kuvendi Komunal".

-Ngastra kadastrale P-72614055-01279-7 në vendin e quajtur "Novi Obiliq" Lloji i shfrytëzimit të parcelës-bujqësore.Arë e kl.1 , me sipërfaqe prej 2504$m^2$ e evidentuar në Certifikatën e pronës nr.05-238-2018 e dt.29.03.2018 ZK.Obiliq e evidentuar si Pronë "Pasuri Shoqërore Kuvendi Komunal".

-Ngastra kadastrale P-72614055-01279-10 në vendin e quajtur "Novi Obiliq" Lloji i shfrytëzimit të parcelës-bujqësore.Arë e kl.1 , me sipërfaqe prej 2451$m^2$ e evidentuar në Certifikatën e pronës nr.05-238-2018 e dt.29.03.2018 ZK.Obiliq e evidentuar si Pronë "Pasuri Shoqërore Kuvendi Komunal".

-Ngastra kadastrale P-72614055-01279-15 në vendin e quajtur "Novi Obiliq" Lloji i shfrytëzimit të parcelës-bujqësore.Arë e kl.1 , me sipërfaqe prej 577$m^2$ e evidentuar në Certifikatën e pronës e dt.30.03.2018 ZK.Obiliq e evidentuar si Pronë "Pasuri Shoqërore Kuvendi Komunal".

- Ngastra kadastrale P-72614051-00562-1 në vendin e quajtur "Vishe Sela KOD MOSTA" Lloji i shfrytëzimit të parcelës-bujqësore kullosë e kl. 1 me sipërfaqe prej 10503 $m^2$ e evidentuar në Certifikatën e pronës nr.05-238-2018 e dt.29.03.2018 ZK.Milloshevë e evidentuar si "P.SH.KK.OBILIQ".

- Ngastra kadastrale P-72602001-00503-1 në vendin e quajtur "KALDRME" Lloji i shfrytëzimit të parcelës-Bujqësore.Kullosë e Klasës 4 me sipërfaqe prej 6653 $m^2$ e evidentuar në Certifikatën e pronës nr.05-238-2018 e dt.28.03.2018 ZK.Babimoc e evidentuar si "P.SH.Kuvendi Komunal Obiliq".

- Ngastra kadastrale P-72602001-00503-5 në vendin e quajtur "KALDRME" Lloji i shfrytëzimit të parcelës-Bujqësore.Kullosë e Klasës 4 me sipërfaqe prej 2698 $m^2$ e evidentuar në Certifikatën e pronës nr.05-238-2018 e dt.29.03.2018 ZK.Babimoc e evidentuar si "P.SH.Kuvendi Komunal Obiliq".

**Neni 2**

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së lartëcekur ësihtë zhvillimi i veprimtarise industriale respektivisht ndertimi i ndonjë fabrike prodhuese apo përpunuese sipas standardeve të përcaktuara me dispozita ligjore.

**Neni 3**

Sipas nenit 1 të këtij vendimi, prona jpet në shfrytëzim afatgjatë prej 15 deri 99 vite nëpërmjet konkursit publik të përcaktuar sipas Rregullores QRK. Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

**Neni 4**

Procedurën e konkursit publik e zbaton Komisioni Vlerësues në bazë të Vendimit të Kuvendit Komunal Nr.I-24 të dt.28.02.2018, si dhe Rregullores QRK. Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

**Neni 5**

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë që pas përfundimit të zbatimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës të regjistron në librat kadastral si prona te dhëna në shfrytëzim për periudhë afatgjatë.

## Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi,Kadastër dhe Pronë,Drejtoria e Inspekcionit si dhe Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit.

## Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqe të Komunës.

## Arsyetim

Baza ligjore për të miratuar këtë propozim Vendim është përcaktuar me dispozitat e neneve 12.1 , 17 pika c) dhe neni 58 pika h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 6,7 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012 ,neneve 11,12 te Rregullores nr.23/2013 te Qeverisë se Republikës së Kosovës për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 72 pika 1.1.8 Statutit të Komunës se Obiliqit Nr.1-34 te dates 25.04.2016 .
Me qëllim të realizimit të interesit publik, rritjes së vlerës ekonomike të pronës komunale si dhe ruajtjes se mjedisit, Komuna e Obiliqit ka planifikuar të jep në shfrytëzim afatgjatë në periudhë deri 99 vite pronat e paluajtshme të Komunës të cekura në nenin 1 të këtij Propozim Vendimi .

**T'i dërgohet**
**-Kryetarit**
**-Kryesuesit**
**-Drejtorit të ad.së përgj.**
**-Paleve**
**-Këshilltarëve**
**-MAPL**
**-Arkivit**

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal**
**Burim Gërguri**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72614055-01790-24

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | **05/1467/2018** |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 08.05.2018 - 09:43 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | Obiliq / Obilić / Obiliq |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | OBILIQ / OBILIĆ / OBILIQ |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | Obiliq / Obilić / Obiliq |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **P-72614055-01790-24** | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Rural | **3221** | Ndarja e parceles ne bazë te Vendum Perfundumtar Nr.04/113 dt. 16.01.2013 Qeveria e Republikës së Kosovës | 13.09.2016 | 20.09.2016 |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendbanimi - adresa<br>Prebivaliste - adresa<br>Resident - address | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address Details | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| DRAGODAN/DRAGODAN/DRAGODAN | | DRAGODAN | 13.09.2016 | 20.09.2016 |

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Povrsina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Arat/Njive/Arable | Arë E Klasës 2/Njiva 2 Klase/2nd Class Arable Land | 3221 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor | PASURI SHOQËRORE KUVENDI KOMUNAL | KCID2603880 | OBILIQ / OBILIC / OBILIQ / | | | 1/1 | | 13.09.2016 |

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : OBILIQ

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Obiliq

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m2 |
|---|---|---|
| P-72614055-01790-24 | Parcelë / Parcela / Parcel | 3221,0 |
| | | |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:617

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 08.05.2018

Koha/ Vreme/ Time: 09:53:02

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Nr. 1-85 Data 23.05.2018

Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Komuna Obiliq - Opština Obilić - Municipality Obiliq

Në bazë të nenit 6 dhe 8 të Ligjit nr.04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtëshme të Komunës, neni 2 paragrafi 4 pika 4.2 dhe neni 11 e Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës ,si dhe Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës, Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit, shpallë këtë :

## NJOFTIM
## PËR PJESËMARRJE NË KONKURS PUBLIK

Komuna e Obiliqit, në pajtim me Vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës Nr. I-58 të dt.30.03.2018 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të Komunës, do të jep në shfrytëzim afatgjatë prej 15 deri 99vite, pronat e paluajtshme si në vijim :

| Nr | Pronar | Zona Kadastrale | Ngastra Kadastrale | Sipërfaqja | Kultura | klasa |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | PASURI SHOQËROR E KUVENDI KOMUNAL | OBILIQ | P-72614055-01279-15 | 577m² | Arë | I |
| 2. | PASURI SHOQËROR E KUVENDI KOMUNAL | OBILIQ | P-72614055-01279-10 | 2451m² | Arë | I |
| 3. | PASURI SHOQËROR E KUVENDI KOMUNAL | OBILIQ | P-72614055-01279-7 | 2504m² | Arë | I |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4. | PASURI SHOQËROR E KUVENDI KOMUNAL | OBILIQ | P-72614055-01279-4 | 2973m² | Arë | 1 |
| 5. | PASURI SHOQËROR E KUVENDI KOMUNAL | OBILIQ | P-72614055-01279-3 | 2881m² | Arë | 1 |
| 6. | PASURI SHOQËROR E KUVENDI KOMUNAL | OBILIQ | P-72614055-01790-30 | 1004m² | Arë | 2 |
| 7. | PASURI SHOQËROR E KUVENDI KOMUNAL | OBILIQ | P-72614055-01790-28 | 1891 m² | Arë | 2 |
| 8. | PASURI SHOQËROR E KUVENDI KOMUNAL | OBILIQ | P-72614055-01790-26 | 675m² | Tokë Ndërtim ore- Oborr | |
| 9. | PASURI SHOQËROR E KUVENDI KOMUNAL | OBILIQ | P-72614055-01790-24 | 3221m² | Arë | 2 |
| 10. | PASURI SHOQËROR E KUVENDI KOMUNAL | OBILIQ | P-72614055-01790-11 | 4502m² | Tokë Ndërtim ore- Oborr | |
| 11. | P.SH.KK.OBILIQ | MILLOSHEVË | P-72614051-00562-1 | 10503m² | Kullosë | 1 |
| 12. | P.SH KUVENDI KOMUNAL OBILIQ | BABIMOC | P-72602001-00505-5 | 2698m² | Kullosë | 4 |
| 13. | P.SH KUVENDI KOMUNAL OBILIQ | BABIMOC | P-72602001-00503-1 | 6653m² | Kullosë | 4 |

Aplikuesit mund të konkurojnë për marrjen në shfrytëzim të një apo më shumë pronave sipas parimit një ofertë një pronë.

20. Planin dinamik te realizimit të investimit nder vite.

Oferta më e mirë do të përzgjedhet mbi bazën e kritereve të përcaktuara në nenin 13 të Kregullores QRK Nr.23/2013:

1. Oferta Ekonomikisht më e favorshme;
2. Vlera e investimit;
3. Numri i të punësuarve nga investimi;
4. Lloji i investimit që është me interes publik për Komunën;
5. Përjashtuar investimin me kapacitete që në çfarëdo mënyre ndikojnë negativisht në gjendjen ambientale sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, dhe kritereve të Bashkimit Evropian;

Pjesëmarrësve në konkurs publik u garantohet e drejta që të:

-Informohen lidhur me procedurat e konkursit publik;
- Të shohin pronën që do të jetë objekt i dhënies në shfrytëzim;
- Të kenë qasje në dokumentacionet e pronës;
- Të tërhiqen nga konkursi jo më vonë se tre ditë para hapjes së ofertave.
Konkurimi për pjesëmarrje bëhet duke dorëzuar aplikacionin me ofertë në kovertë të mbyllur (në dy kopje Origjinale).

Oferta duhet të përmbajë :

1. Shënimet e ofertuesit;
2. Numrin e këtij njoftimi;
3. Datën e përpilimit të ofertës;
4. Titullin ofertë, shënimin mbi pronën për të cilin konkurron;
5. Llojin e investimit;
6. Vlerën e investimit;
7. Numrin e të punësuarve;
8. Emrin dhe mbiemrin;
9. Nënshkrimin e ofertuesit për personin fizik;
10. Për personin juridik edhe funksionin e personit përgjegjës;
11. Certifikata e regjistrimit të biznesit;
12. Historia e kompanisë (biznesit) që aplikon;
13. Veprimtaria që do të zhvillojë;
14. Projekti ideor;
15. Vërtetim nga Komuna dhe Administrata Tatimore e Kosovës për përmbushjen e obligimeve tatimore;
16. Dëshmi nga ATK për numrin aktual të të punësuarve;
17. Planin e biznesit;
18. Referenca për aktivitetin biznesor;
19. Shfrytëzuesit e deritanishëm, dëshmitë që nuk kanë borxh ndaj Komunës; si dhe
20. Planin dinamik të realizimit të Investimit ndër vite.

Oferta më e mirë do të përzgjedhet mbi bazën e kritereve të përcaktuara në nenin 13 të Kregullores QRK Nr.23/2013:

1. Oferta Ekonomikisht më e favorshme;
2. Vlera e investimit;
3. Numri i të punësuarve nga investimi;
4. Lloji i investimit që është me interes publik për Komunën;
5. Përjashtuar investimin me kapacitete që në çfarëdo mënyre ndikojnë negativisht në gjendjen ambientale sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, dhe kritereve të Bashkimit Evropian;

6. Përfitimi financiar i Komunës; si dhe
7. Rritja e vlerës së Pronës.

Oferta e personit fizik duhet të nënshkruhet nga personi fizik, ndërsa oferta e personit juridik nënshkruhet dhe vuloset nga personi përgjegjës i personit juridik.

Oferta për pronën e caktuar duhet të vendoset në kovertë të mbyllur.
Koverta në faqen e parë duhet të përmbajë shënimin:

**Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit**
**Pjesëmarrje në Konkurs Publik**

Tërheqja e aplikacioneve mund të bëhet në ndërtesën e Komunës, rr. "Adem Jashari" kati -I- në Qendrën për Shërbime me Qytetarë dhe në formë elektronike nga Webfaqja e Komunës.

Aplikacioni bashkë me ofertën në kovertë të mbyllur dorëzohet brenda afatit prej 45 dite nga dita e shpalljes së këtij njoftimi deri në ora 16:00 në ndërtesën e Komunës kati 1 në Qendrën për Shërbime me Qytetarë .

Hapja e ofertave do të mbahet në ndërtesën e Komunës në Sallën e Kuvendit Komunal pas një (1) dite mbylljes së konkursit, duke filluar në ora 10.00.

Ofertat e paprecizuara, të panënshkruara nuk do të merren në shqyrtim.
Gjatë hapjes së ofertave në konkurs publik marrin pjesë nënshkruesit e ofertave përkatësisht të autorizuarit e tyre me autorizim noterial.

Komisioni vlerësues në konkurs i bënë publike vlerat e investimeve si dhe numrin e të punësuarve të secilës ofertë për pronën përkatëse.

Konform nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së cekur më lart, Komisioni vlerësues i dorëzon Kryetarit të Komunës dhe Kryesuesit të Kuvendit të Komunës raportin përfundimtar të vlerësimit të ofertave si dhe i rekomandon ofertën e përzgjedhur.

Njoftimi për ofertën e përzgjedhur do t'i dërgohet fituesit, do të publikohet në Webfaqen e Komunës dhe në tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës .

Nr.______________ Kryesuesi i Komisionit

Me datë: ________

Nr. -1-120
Br.

Data 24.08.2018
Datum

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

# PROCESVERBAL

Nga Takimi i Komisionit për hapjen e ofertave, të konkursit publik për dhënjen në shfrytëzim të pronës komunale, mbajtur me dt.10.07.2018, në ora 10:15' në Zyren e mbledhjeve të Këshillit të drejtorëve.

**Të pranishëm janë këta anëtarë:** Përparim Klinaku, Kryetar i Komisionit, Naim Miftari, Fatmir Bërbatovci, Armend Rushiti, Labinot Mirena, Dragan Dancetovic dhe Zelushe Kelmendi, e cila më vonë iu bashkangjit Komisionit.

**Të pranishmit tjerë:** përfaqësuesit e kompanive "Agrokor" Veton Sahiti dhe "Katana" Agron Jusufi

Takimin e hapi Përparim Klinaku, Kryetar i Komisionit i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi hapjen e ofertave.

**Përparim Klinaku** – ne kemi shpallë 13 parcela dhe aplikimi për pronën komunale nr.10, është ngastra **P – 72614055 - 01790 - 11**

Agrokori ka konkuru për këtë parcelë.

-Kolegji biznesi , **P – 72614055 – 01790 - 26**

-NTP "Unioni" **P- 72614055 - 0179024**

-Poligoni i shenjëtarisë "Katana" **P – 72614055 – 01279 - 3**

Parcela tjetër **01279 - 4**

Aplikacioni tjetër është **01279 - 7**

**01279-10**

**01279-15**

Aplikacioni Sami Saraqi **P – 72614051 – 00562 - 1**

NTP Las Palmas **P - 72614055 - 0179030**

Agrokor **P - 72614055 - 01790-28**

Ink Station **P – 72614055 – 01790 -24**

Agrokor **P – 72614055 – 01790 - 30**

Burimi sh.p.k.**P - 72602001 - 00505 - 5**

**P - 7260200100503 - 1**

Ne brenda afatit ligjor prej 3 ditësh do të dalim me përfituesin e konkursit.

Takimi përfundoi në ora 10:40'

Bashk.prof.për punë të KK

Azize Zeneli

**Anëtarët e Komisionit:**

Përparim Klinaku, Kryetar ____________

Naim Miftari, anëtar ____________

Labinot Mirena, anëtar ____________

Fatmir Bërbatovci, anëtar ____________

Zelushe Kelmendi, anëtare ____________

Armend Rushiti, anëtar ____________

Dragan Dancetovic, anëtar ____________

DREJTORIA E ADMINISTRATËS PERGJITHSHME
UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE

Dalës Izlazna
Nr. ~1-118 Data 24.08.2018
Br. Datum
OBILIQ-OBILIĆ

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E OBILIQIT-KOSOVË
OPSTINA OBILIĆ – KOSOVO
MUNICIPALITY OF OBILIQ - KOSOVO

**Mbledhja e takimit të Komisionit vlerësues për Dhënien e Pronës në Shfrytëzim me 25.07.2018**

**RENDI I DITËS**

1. **Vlerësimi i ofertave të pranuara,**
2. **Të ndryshme**

Prezent në takim: Përparim Klinaku, Naim Miftari, Zelushe Kelmendi, Armend Rushiti, Labinot Mirena dhe Dragan Danqetoviq.

1. "Burimi" SH.P.K – ngastrat kadastrale nr.: 72602001-00505-5 ZK Babimoc dhe ngastra kadastrale – 72602001-00503-1, ZK Babimoc..
   - Vlera e investimit 800.000 €,
   - Punëtorë në fazën e parë 39 ndërsa totali 50.
2. INKSTATION – Z.K Obiliq, ngastra kadastrale nr.: 72614055-01790-24
   - Investimet në objektë 167,000.00 €,
   - Investimet në makineri 150,000.00 €
   - Punësimi për vitin 2019, 5 punëtorë dhe 20 më vonë.
3. Agro Kor – Z.K Obiliq, ngastra kadastrale:72614055-01790-28,
   - Investimi deri në vitin 2028, 600,000.00 €,
   - Punëtorë 80.

4. Agrokor – Z.K Obiliq, ngastra 72614055-01790-30
   - Investimet deri në vitin 2028, 600.000.00 €,
   - Punëtorë 80.

5. Sami Saraqi –Z.K Milloshevë ngastra kadastrale nr.: 72614051-00562-1.
   - Vlera e Investimit: 1,540,000.00 €
   - Punëtorë: 19.

6. Kolegji Biznesi - Z.K Obiliq ngastra kadastrale nr.: 72614055-01790-26,
   - vlera e investimit 200,000.00 €,
   - Punëtorë,20-30.

7. Las Pallmas Z.K Obiliq, ngastra nr.: 72614055-01790-30.
   - Vlera e investimit 192,100.00 €, për objektin montazhë.
   - Investimi total 300,000.00 €,
   - Punëtorë 3-6.

8. Poligoni i shejtanisë KATANA Z.K Obiliq, ngastrat kadastrale nr.:72614055-01279-3, 72614055-01279-4, 72614055-01279-7, 72614055-01279-10, 72614055-01279-15
   - Vlera totale e investimit 500.425.00 €
   - Punëtorë 13.

9. Agrokor Z.K Obilliq nr. 72614055-01790-11
   - Vlera e investimit deri në vitin 2028 600,000.00 € dhe
   - Punëtorë 80.

10. N.T.P "UNION" – Z.K Obiliq 72614055-01790-24
    - Vlera e investimit 265,000.00 €, dhe
    - Punëtorë 12.

Takimi filloi në ora 10.00, dhe përfundoi në ora: 11: 46 min.

1. **Përparim Klinaku**__________
2. **Naim Miftari**__________
3. **Labinot Mirena**__________
4. **Zelushe Kelmendi**__________
5. **Dragan Danqetoviq**__________
6. **Armend Rushiti**__________

REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E OBILIQIT-KOSOVË

OPŠTINA OBILIĆ – KOSOVO

MUNICIPALITY OF OBILIQ - KOSOVO

**Mbledhja e Komisionit vlerësues për Dhënien e Pronës Komunale në Shfrytëzim me 25.07.2018**

## RENDI I DITËS

1. **Vlerësimi i ofertave të pranuara,**
2. **Të ndryshme**

Prezent në takim: Përparim Klinaku, Naim Miftari, Zelushe Kelmendi, Armend Rushiti, Labinor Mirena dhe Dragan Danqetoviq.

1. Burimi SH.P.K – ngastrat kadastrale nr. 72602001-00505-5 ZK Babimoc dhe ngastra kadastrale - 72602001-00503-1 ZK Babimoc.
- Vlera e investimit 800,000.00 €,
- Punëtorë në fazën e parë 39 ndërsa totali 50.

2. INKSTATION – Z.K Obiliq, ngastra kadastrale nr. 72614055-01790-24,
   - Investimet në objekt, 167,000.00 €,
   - Investimet në makineri, 150,000.00 €
   - Punësimi për vitin 2019, 5 punëtorë dhe 20 më vonë.

3. Agro Kor – Z.K Obiliq ngastra kadastrale 72614055-01790-28,
   - Investimi deri në vitin 2028, 600,000.00 €,
   - Punëtorë, 80.
4. Agro Kor – Z.K Obiliq ngastra 72614055-01790-30
   - Investimet deri në vitin 2028, 500,000.00 €.
   - Punëtorë 80.
5. Sami Saraqi –Z.K Milloshevë ngastra kadastrale nr.72614051-00562-1,
   - Vlera e investimit 1,540,000.00 €
   - Punëtorë 19.

REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E OBILIQIT-KOSOVË

OPŠTINA OBILIĆ – KOSOVO

MUNICIPALITY OF OBILIQ - KOSOVO

**Mbledhja e Komisionit vlerësues për Dhënien e Pronës Komunale në Shfrytëzim me 25.07.2018**

## RENDI I DITËS

1. **Vlerësimi i ofertave të pranuara,**
2. **Të ndryshme**

Prezent në takim: Përparim Klinaku, Naim Miftari, Zelushe Kelmendi, Armend Rushiti, Labinor Mirena dhe Dragan Danqetoviq.

1. Burimi SH.P.K – ngastrat kadastrale nr. 72602001-00505-5 ZK Babimoc dhe ngastra kadastrale - 72602001-00503-1 ZK Babimoc.
- Vlera e investimit 800,000.00 €,
- Punëtorë në fazën e parë 39 ndërsa totali 50.

2. INKSTATION – Z.K Obiliq, ngastra kadastrale nr. 72614055-01790-24,
   - Investimet në objekt, 167,000.00 €,
   - Investimet në makineri, 150,000.00 €
   - Punësimi për vitin 2019, 5 punëtorë dhe 20 më vonë.

3. Agro Kor – Z.K Obiliq ngastra kadastrale 72614055-01790-28,
   - Investimi deri në vitin 2028, 600,000.00 €,
   - Punëtorë, 80.
4. Agro Kor – Z.K Obiliq ngastra 72614055-01790-30
   - Investimet deri në vitin 2028, 500,000.00 €.
   - Punëtorë 80.
5. Sami Saraqi –Z.K Milloshevë ngastra kadastrale nr.72614051-00562-1,
   - Vlera e investimit 1,540,000.00 €
   - Punëtorë 19.

Nr. -1-119 Data 24.08.2018

REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E OBILIQIT-KOSOVË

OPSTINA OBILIĆ - KOSOVO

MUNICIPALITY OF OBILIQ - KOSOVO

**Mbledhja e Komisionit vlerësues për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim me dt. 08.08.2018.**

**Takimi filloi në ora 10:00.**

**Prezent ishin:**

**Përparim Klinaku, Naim Miftari, Fatmir Bërbatovci, Armend Rushiti, Labinot Mirena.**

Munguan: Dragan Danqetoviq i cilil është në pushim si dhe Zelushe Kelmendi.

**Kryesuesi i komisionit konstatoi se ka kuorum dhe mbledhja mund te filloj si dhe propozoi**

**REND DITE**

1. **Nxjerrja e rekomandimeve për përfituesit e ofertës më të favorshme dhe**
2. **Të ndryshme.**

**Aprovohet Rendi i Ditës.**

Pas vlerësimit të ofertave, komisioni votoi vec-vec dhe nw mwnyrw unanime për secilen ofertë, duke perzgjedhur Ofertat më të favorshme sipas kritereve të parapara në njoftimin publik dhe në mënyrë rekomandon ofertat përfituese:

1. Për ngastrat kadastrale: P-72602001-00505-5 sipërfaqja 2698m$^2$, P-72602001-00503-1 sipërfaqja 6653m$^2$, ZK Babimoc, bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme rekomandojmë që përfitues i këtyre parcelave të shpallet "Burimi" SH.P.K.

2. Për ngastrën kadastrale: P-72614055-01790-24 sipërfaqja 3221m$^2$, ZK Obiliq, bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme rekomandojmë që përfitues i kësaj parcele të shpallet ofertuesi, N.T.P.UNION

3. Për ngastrat kadastrale: P-72614055-01790-28 sipërfaqja 1891m$^2$, P-72614055-01790-30 sipërfaqja 1004m$^2$ dhe P-72614055-01790-11 sipërfaqja 4502m$^2$, ZK Obiliq, bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme rekomandojmë që përfitues i kësaj parcele të shpallet, ofertuesi "Agro Kor" SH.P.K.

4. Për ngastrat kadastrale: P-72614055-01279-15 sipërfaqja 577m$^2$, P-72614055-01279-10 sipërfaqja 2451m$^2$, P-72614055-01279-7 sipërfaqja 2504m$^2$, P-72614055-01279-4 sipërfaqja 2973m$^2$ dhe P-72614055-01279-3 sipërfaqja 2881m$^2$ ZK Obiliq. Bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme rekomandojmë që përfitues i këtyre parcelave të shpallet POLIGONI I SHENJËTARISË "KATANA" SH.P.K.

5. Për ngastrën kadastrale nr.: P-72614051-00562-1, sipërfaqja 10503 m$^2$, ZK Milloshevë, bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme rekomandojmë që përfitues i kësaj parcele të shpallet ofertuesi, Sami Saraqi.

Ofertat të cilat janë refuzuar:

1. Ofertuesi "INKSTATION" i cili ka ofertuar për parcelen P-72614055-01790-24 në sipërfaqe 3221m$^2$.

2. Ofertuesi "Kolegji Biznesi" i cili ka ofertuar për parcelen P-72614055-01790-26 në sipërfaqe 675m$^2$.

3. Ofertuesi "Las Palmas" i cili ka ofertuar për parcelen P-72614055-01790-30 në sipërfaqe 1004m$^2$.

Takimi përfundoi në ora 11.10 min.

Prezent:

1. Përparim Klinaku ____________
2. Naim Miftari ____________
3. Fatmir Bërbatovci ____________
4. Armend Rushiti ____________
5. Labinot Mirena ____________

Konkurs për toke shfrytëzim 99 / për pronë komunale

| Numri rendor Shënja | LËNDA | Lëvizja e lëndës | Mënyra e zgjidhjes | VREJTJE |
|---|---|---|---|---|
| 01 | 29.06.2018 Sami Sorogi | Dorëzoi [signature] Pranoi Përpilim Kliaku [signature] 08.07.2018 | për shfrytëzim të pronës komunale 99 vit | |
| 02 | N.T.P. LAS PALLMAS 03.07.2018 | | për shfrytëzim të pronës komunale 99 vit | |
| 03 | N.T.P UNION Rr. Hasan Prishtina 05.07.2018 Ko. Obiliq | | për shfrytëzim të pronës komunale 99 vite | |
| 04 | Inkstation 06.07.2018 | | për shfr. pronës komunale 99 vite | |
| 05 | Poligoni i shkentarisë Kosova Shqip 06.07.2018 | | shfrytëzim pronës komunale 99 vite | |
| 06 | Agrokon 06.07.2018 | | shfrytëzim pronës komunal 99 | |
| 07 | Agrakon 06.07.2018 | | shfrytëzim pronë komunal 99 | |
| 08 | Agrokon 06.07.2018 | | prone shfrytëzim komunale 99 | |
| 09 | Burimi Shqip 06.07.2018 | | shfrytëzim pronës komunale 99 vite | |
| 10 | Kolegji Biznesi | | shfrytëzim pronës komunale 99 vite | |

PORTOKOL I SHKURT

N.T.P. UNION Rr."Hasan Prishtina" pa Nr. Obiliq

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

# OFERTE

LIDHUR ME KONKURSIN PUBLIK TE KOMUNES SE OBILIQIT ,QE KA TE BEJE ME VENDIMIN PARAPRAK TE KK OBILIQ Nr . 1-58 DT 30.03.2018 PER DHENJEN NE SHFRYTEZIM AFATGJAT TE PRONES SE PALUJTESHME TE KK OBILIQ TE PUBLIKUAR ME 23.05.2018 Nr.PROTOKOLLIT : 1-85

OFERTA ESHTE PER :

PASURI SHOQERORE E KUVENDIT KOMUNAL OBILIQ ,NGASTRA KATASTRALE: P-72614055-01790-24 ,

SIPERFAQJA PREJ : 3221 m², KULTURA: ARE , KLSA: 2

KASTRIOT (OBILIQ) 05 07 2018

05. 07. 2018

03 2018